



REPUBLIKA E KOSOVES PERBIRJA
 AGENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
 ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. _____
 Dep. DPR1
 Nr. I faq. _____
 Broj stranica _____
 Nr. pages _____

Nr Prot. _____
 Br. Prot. _____
 Prot No. 03-02/4444/16
 Data _____
 Datum 25.11.2016
 Date _____

PRISHTINË



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 25.11.2016, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK- 03 - 02-2973/16, për z. Agim Kuçi - Gjyqtar në Gjykatën Themelore të Prishtinës, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK - 03 -02 - 2973/16, për zyrtarin e lartë z. Agim Kuçi - Gjyqtar në Gjykatën Themelore të Prishtinës, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Zyrtari i lartë z. Kuçi është hetuar për konflikt interesi sepse krahas funksionit publik të Gjyqtarit, ka qenë person i autorizuar në biznesin privat: "MMB".

Agjencia kundër Korrupsionit (AKK) fillimisht i ka dërguar shkresën zyrtare me të cilën e ka njoftuar për fillimin e procedurës për shqyrtimin e konfliktit të interesit, pas së cilës zyrtari i lartë është takuar me zyrtarët e Agjencisë.

Në takim z. Ismaili është njoftuar me kufizimet në ushtrimin e funksioneve tjera, krahas ushtrimit të funksionit publik dhe për ndryshimet që duhet të bëj për të shmangur konfliktin e interesit. Ai ka premtuar që në afat sa më të shpejt do të largohet nga ky funksion në mënyrë që të shmang konfliktin e interesit.

Ndërkohë ka dërguar në Agjenci shkresën zyrtare, të lëshuar nga Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë, me të cilën vërtetohet se, vullnetarisht, ka mbyllur biznesin privat "MMB". Me këtë zyrtari i lartë ka shmangur situatën e konfliktit të interesit në të cilin ndodhej.

II. Në pajtim me nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

Shaip Havolli

